

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN, RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është ndryshimi i disa parametrave zhvillimorë sipas tipologjisës së ndërtimeve të përcaktuar në VKM nr 283/2015, “*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*”, të ndryshuar. Këto ndryshime vijn si rezultat të nevojave të fermerëve dhe blegtorëve gjatë zhvillimit e aktivitetit të tyre në sektorin e bujqësisë dhe të blegtorisë.

Objektiv i projektvendimit është përditësimi i përcaktimeve të vendimit që ndryshohet në përputhje me kriteret e legjislacionit të zhvillimit dhe planifikimit të territorit që ngelet i cili është i zbatueshëm gjatë planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe ndërtimeve të objekteve bujqësore në tokë bujqësore.

Ndërtimet në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë kanë sjellë impakt social dhe ekonomik në zonat rurale , si dhe ndryshimet e kërkuara në projektvendim nuk çenojnë përdorimin racional të sipërfaqes së tokës bujqësore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është parashikuar në programin e projektakteve të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2024.

Relacion për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 107/2015 “Për zhvillimin dhe planifikim e territorit”, i ndryshuar ka si qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore, duke patur në konsideratë mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet.

Ligji nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar ka përcaktuar që ndërtimi i objekteve me karakter bujqësor dhe blegtoral lejohen në gjitha kategoritë e tokës.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, i ndryshuar, ka bërë të mundur ndërtimin e objekteve me karakter bujqësor dhe blegtoral në tokë bujqësore sipas tipologjisë dhe standardeve të përcaktuara në vendim duke i dhënë mundësi shfrytëzimit, ruajtjes dhe përpunimit të prodhimit bujqësor, blegtoral të produkteve vendase.

Ndryshimet ligjore të kërkuara për strukturat me karakter bujqësor dhe blegtoral janë në përputhje me politikat sektoriale të MBZHR, politika që kanë si prioritet rritjen e prodhimit bujqësor vendas , rritjen e vlerës së produkteve dhe të të ardhurave të fermerëve. Rritja e prodhimit kërkon konsolidimin e magazinimit të ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore.

Në sektorin blegtorisë politikat sektoriale synojnë në plotësimin e kushteve për mbarështimin e qëndrueshëm të kafshëve të fermës si dhe përmirësimin racor e cial arrihet përmes ndërtimit të stallave bashkëkohore.

Përmirësimet konkrete janë :

1. Ndryshimet kryesore të synuara janë :
 - Lehtësimin e ndërtimit të serrave pa themele të vazhdueshme me nen të veçantë, në ndryshim si aktualisht ku ndërtohen me miratim të deklaratës paraprake nga NjVV.

Relacion për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar

- Rritjen e sipërfaqes së tokës në një parcel, në dispozicion të serrave, duke ruajtur distancën nga pronat kufitare. Parcela do përdoret nga 70 përqind që është aktualisht në 90 përqind.
- Rritja e intensitetit që lejon objekte ndërtimore më të mëdha dhe kapacitet të shtuar të mbajtjes së kafshëve, ndërtimin në dy kate për zyrave, ambienteve ndihmëse, futjen e konceptit deri në ulluk etj. Pra, në parim, rritje e volumit të ndërtimit në lartësi.
- Ndërtim i mureve rrethuese të ndërtime, riparimi i çative, mbulesave etj. pa leje ndërtimi të veçantë.
- Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për të vlerësuar kërkesat për leje ndërtimi, si akti më i rëndësishëm në kuadër të ndërtimit.

Sqarojm se Planet e Përgjithshme Vendore zbatohen në çdo aplikim për leje ndërtimi, në rastet kur ka PPV të miratuar, sikurse dhe Planet e Detajuara Vendore. Ndërkohë në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nuk ka plane të miratuara gjen zbatim Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 1.4.2015 dhe nëse ka, akte të autoriteteve të planifikimit të territorit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi miratohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës, pika 5/2, e nenit 11/1, të Ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar,

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Për projektaktin nuk aplikohet përafrimi me Acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi ka 4 pika me formulimin si vijon.

1. Pika 4, e nënkreut II.a, ndryshohet si më poshtë:

“4. Për qëllim të llogaritjes së vëllimit/sipërfaqes së ndërtimit, në intensitetin e ndërtimit përfshihet ngastra ose bllok ngastrash edhe kur ndahen nga

Relacion për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar

rrugë, kanale apo kufij të tjerë natyralë, në pronësi apo përdorim. Leje ndërtimi shtesë për të njëjtën parcel/ngastër miratohet vetëm nëse nuk është shteruar intesiteti sipas Planit të Përgjithshëm Vendor ose Planit të Detajuar Vendor. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore që nuk kanë Planit të Përgjithshëm Vendor, leje ndërtimi për të njëjtën pasuri mund të nxirret vetëm pas miratimit të PPV.”.

2. Në nënkreun II.b bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a. në shkronjën “a” të pikës 1, vëllimi “0.03 m³/m²” zëvendësohet me vëllimin “3 m³/m²”;

b. shkronja “b”, e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“b) Të zhvillohen në një kat të vetëm dhe të respektojnë lartësinë maksimal 5.5 metër në ulluk dhe lartësi maksimale 12 metër në kulm, me përjashtim të oxhakëve, siloseve dhe strukturave që tejkalojnë këtë lartësi për shkak të karakteristikave teknike.”

c. pika 3 ndryshon si vijon:

“3. Stallat, pavarësisht numërit të krerëve të parashikuar për mbarështim, duhet të plotësojnë këto kritere:

a. *Të respektojnë distancat minimale të mëposhtme:*

i. *20 metër nga kufijtë e pronës;*

ii. *300 metër nga zonat e banuara;*

iii. *50 metër nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.*

b. *Të zhvillohen në një kat të vetëm, me lartësi të ndryshme në bazë të karakteristikave të veçanta teknike dhe lartësi maksimale 5 m në ulluk dhe jo më shumë se 12 metër në kulm;*

c. *Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkalojë intensitetin e ndërtimit prej 4m³/m².”*

ç. Në pikën 7 përqindja “70%” zëvendësohet me përqindjen “90%”.

d. Në shkronjën “a” të pikës 10 vëllimi “1 m³/m²” zëvendësohet me vëllimin “4 m³/m²”.

dh. Shkronja “b” e pikës 10 ndryshon si më poshtë:

“b) Të respektojnë distancat minimale prej 4 metër nga kufijtë e pronës dhe distancat nga ndërtimet e tjera pa cënuar funksionalitetin e tyre.”

e. Në shkronjën “a”, të pikës 11, vëllimi “1 m³/m²” zëvendësohet me vëllimin “4 m³/m²”.

3. Shkronja “b”, e pikës 3, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“b) leja e ndërtimit, në rastet e njërive të vetëqeverisjes vendore që kanë plane rregulluese të miratuara, lëshohet pas verifikimit të

Relacion për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar

përputhshmërisë me planin rregullues. Në rastet kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk ka plan rregullues të miratuar, leja lëshohet pas kontrollit të përputhshmërisë së projekt-propozimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, dhe vlerësimit nga ministria përgjegjëse për bujqësinë për përpërputhshmërinë e tipologjisë së objekteve sipas Kreut I të këtij vendimi”.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi në pikën 4, përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet MBZHR, MIE dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT


Projektvendim është hartuar nga Grupi Punës ngritur me Urdhërin nr 16, date 17.1.2024, në MBZHR.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij vendimi nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

ANILA DENAJ



Relacion për projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të këshillit të ministrave, “për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar